



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KGJK. Nr. 111/2021

Datë: 15 prill 2021

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 7 paragraf 1, pika 1.14 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, duke vendosur në çështjen disiplinore ndaj Mileva Tomoviq, ish gjyqtare në Gjykatën Themelore në Pejë-dega në Klinë, sipas raportit të Panelit Hetimor Nr.AD/KGJK/20/2020/ GJTHPE – AD.nr.06/20, të datës 9 korrik 2020, pas seancës dëgjimore të mbajtur më datë 15 prill 2021, në pajtim me nenin 14, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, dhe nenit 19 dhe 20 të Rregullores (05/2019) për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, nxjerr këtë:

V E N D I M

Mileva Tomoviq, ish gjyqtare e Gjykatës Themelore në Pejë-dega në Klinë, **nuk është përgjegjëse**, për shkeljen disiplinore të përcaktuar nga neni 5, paragrafi 2, pika 2.7, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

A r s y e t i m

Paneli hetimor i themeluar me vendim të Këshillit Gjyqësor të Kosovës KGJK.nr.68/2020, të datës 10 prill 2020, për lëndën disiplinore Nr.AD/KGJK/20/2020/GJTHPE – AD.nr.6/2020, i ka paraqitur Këshillit Gjyqësor të Kosovës raportin mbi hetimin e bërë lidhur me shkeljen e pretenduar disiplinore të ish gjyqtarës të Gjykatës Themelore në Pejë-dega në Klinë, Mileva Tomoviq, e cila është dyshuar nga Autoriteti Kompetent se gjatë zhvillimit të procedurës gjyqësore në lëndën C.nr.152/12, nuk ka kryer me kohe detyrat zyrtare siç kërkohen me Ligjin për Procedurën Kontestimore për çka ka vlerësuar se gjyqtarja ka shkelur obligim e saj ligjor për kryerjen e detyrës zyrtare siç është paraparë me Ligj.

Sa i përket pretendimit të Autoritetit Kompetent që ish gjyqtarja Tomoviq ka shkelur Ligjin për Procedurën Kontestimore me rastin e caktimit të përfaqësuesit të përkohshëm avokatin Xh.R nga Peja, për të paditurit R.M.V, B.R.V, dhe S.S.M, sipas Aktvendimit C.nr.152/12, të datës 16.12.2019, paneli hetimor nuk ka gjetur se ka shkelje në nxjerrjen e këtij aktvendimi për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm, me rastin e zgjerimit të padis edhe ndaj të paditurve pasi i njëjti aktvendim ishte publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Ndërsa paneli hetimor ka konstatuar se gjyqtarja Tomoviq ka dështuar të veproj konform dispozitave të nenit 306, të Ligjit për Procedurën Kontestimore sa i përket caktimit të masës së përkohshme të sigurimit ndaj të cilës mase ishte ushtruar kundërshtim dhe më këtë rast gjyqtarja Tomovic ka dështuar të veproj sipas paragrafit 2 dhe 3, të nenit 307, të të njëjtit Ligjit duke mos shqyrtuar kundërshtimin e ushtruar nga përfaqësuesi të paditurve M.K, Z dhe M.Sh. të avokatit

Këshilli Gjyqësor i Kosovës për të shqyrtuar këtë çështje, me datë 15 prill 2021, ka caktuar dhe mbajtur seancën dëgjimore në të cilën morën pjesë kryesuesi i panelit hetimor gjyqtari Fejzullah Rexhepi dhe subjekti i hetimit disiplinor, ish gjyqtarja Mileva Tomoviq.

Kryesuesi e panelit hetimor në fillim të seancës dhe në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se qëndron pran raportit të bërë me shkrim dhe provave të bashkangjitura.

Ish Gjyqtarja Tomoviq në seancën dëgjimore ka deklaruar se ajo kishte bërë përpjekje disa herë që të caktohet dhe të mbahen seanca dëgjimore për lëndën C.nr.152/12, mirëpo kanë munguar palët, ka qenë lëndë e komplekse për shkak të palëve që kanë jetuar në shtete tjera. Ka theksuar se masën e sigurisë për këtë lëndë nuk e kishte caktuar ajo por gjyqtari tjetër që e kishte pas këtë lëndë para saj. Ka shtuar se qenë e ngarkuar me një numër të madh të lëndëve dhe ka bërë shumë përpjekje që edhe kjo sikurse lëndët e tjera të caktohet dhe të mbahet seancat gjyqësore por e vetmja seancë ku ishin plotësuar kushtet ligjore për mbajtje e saj ka qenë seanca e datës 24 shkurt 2020, mirëpo edhe kjo nuk kishte arrite që të mbahet pasi që nga avokati i njëjës pale ishte kërkuar përjashtimi i gjyqtarës, për çka i është dashur ta ndërprej seancën gjyqësore dhe të pres deri në vendosjen lidhur me kërkesën për përjashtimin ose jo të saj në trajtimin e mëtejshëm të kësaj çështjeje. Për këtë e njëjta nuk ka ndërmarr asnjë veprim tjetër dhe me datë 1 mars 2020 ka dalë në pension.

Për të vërtetuar drejtë gjendjen faktike, KGJK administroj provat materiale siç janë: Raportin mbi faktet dhe provat e mbledhura gjatë procedurës hetimore të datës 09.07.2020, Kërkesa për inicim të procedurës disiplinore e ushtruar nga Autoriteti Kompetent, Transkriptin e seance se mbajtur nga Paneli hetimor i datës 06.07.2020, Procesverbalet e datave 16.05.2018, 25.10.2018, 12.07.2018, 12.06.2018, 10.02.2019, 13.01.2019, 25.09.2019, 19.08.2019, 18.10.2019, 16.12.2019, 15.11.2019, 24.02.2020 dhe Ankesën e ushtruar nga avokati Teki Bokshi kundër ish gjyqtarës Mileva Tomoviq.

Pas vlerësimit të të gjitha provave një nga një dhe të gjitha se bashku, KGJK-ja vlerësoj se nuk qëndron pretendimi i Autoritetit Kompetent se ish Gjyqtarja Mileva Tomoviq, ka kryer shkelje disiplinore të përcaktuara nga neni 5, paragrafi 2, pika 2.7, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Pasi që vlerësoj se ish gjyqtarja Tomoviq kishte caktuar disa seanca gjyqësore për lëndën C.nr.152/12, mirëpo të njëjtat nuk janë arrite të mbahen për shkak të pengesave procedurale përkatësisht mungesës së palëve në procedurë. Nga shkresat e lëndës shihet se seanca e vetme në të cilën ishin plotësuar kushtet ligjore ka qenë seanca e datë 24 shkurt 2020, mirëpo e njëjta nuk ka mund të përfundohet meqenëse nga njëra palë në procedure ishte kërkuar përjashtimi i gjyqtarës nga trajtimi i këtij rasti. Për çka gjyqtarës i është dashur ta ndërpres seancën gjyqësore dhe të njëjtën nuk ka mund ta vazhdoj pasi që në ndërkohë përkatësisht me 1 mars 2020 e njëjta ka arrit moshën e pensionimit.

Nga provat e administruara KGJK nuk ka arritur të vërtetoj se ish gjyqtarja Tomoviq ka bërë shkelje disiplinore të përcaktuara nga neni 5, paragrafi 2, pika 2.7, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, të pretenduara nga ankuesi edhe nga Autoriteti Kompetent.

Nga sa u tha me lartë u vendosë si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KGJK.nr.111/2021, datë: 15 prill 2021

Skender COÇAJ,

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejt ankese brenda 15 ditëve, pas pranimit të vendimit drejtpërdrejt në Gjykatën Supreme të Kosovës.

Kopje e vendimit i dërgohet:

- *Armend Berisha, Kryetar, Gjykata Themelore në Pejë;*
- *Mileva Tomovic, ish Gjyqtare, Gjykata Themelore në Pejë;*
- *Shkelzen Maliqi, Drejtor i Përgjithshëm i SKGJK-së;*
- *Arkivit.*